

Partneriteti me Bankën Botërore



Një marrëdhënie bashkëpunimi e partneriteti e suksesshme është realizuar me institucionin e BB në Shqipëri. Në sajë të marrëveshjes së kësaj banke me qeverinë shqiptare dhe bashkëpunimit ngushtësisht me Bashkinë Kamëz është arritur të financohet nga kjo bankë hartimi i studimit për zhvillimin

urban të Kamzës, i cili tashmë ka përfunduar. Ky studim e vë Bashkinë Kamëz, si pak bashki në Shqipëri, në binarë të fortë rregullatorë për zbatimin e zhvillimin urban të qytetit mbi bazën e normave dhe standardeve urbane bashkëkohore.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij partneriteti është bërë i mundur financimi për ndërtimin e 4 shkollave të reja, me standarde të larta bashkëkohore, për sa i përket konstruksionit, numrit të mjediseve dhe hapësirave të tyre, pajisjeve, kabineteve, laboratorëve, sallave, palestrës, ambienteve të ndihmës shëndetësore etj. Dy nga këto shkolla kanë përfunduar dhe dy të tjerat janë në proces. Njëkohësisht, ky partneritet është shtrirë edhe në fushën e infrastrukturës, në kuadër të projektit të menaxhimit të tokës urbane (LAMP), për përmirësimin dhe asfaltimin e tri rrugëve kryesore, “Teuta”, “Bavaria” dhe “Xhorxh Bush”. Në realizimin e projekteve të arritura deri tani nga bashkia, nëpërmjet partneritetit me Bankën Botërore, është vlerësuar nga ky institucion cilësia e këtij bashkëpunimi në aspekt profesional, korrektesa, transparenca, korrespondenca tekniko-ligjore etj.